REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HAS
DREJTORIA E MBROJTJES CIVILE
EMERGJENCAT CIVILE

Nr.3004/1 Prot.

Krumë, me 12/08/2026

RELACION

KËSHILLIT BASHKIAK HAS

PËR

Miratimin e kërkesës së Bashkisë Has së bashku me dokumentacionin tekniko-ligjor për akordimin e ndihmës financiare për familjen e Z. Shkelzen Halil Brati banesa e të cilit është dëmtuar nga reshjet e dendura të shiut.

Të nderuar Këshilltarë!

Në zbatim të ligjit Nr.139/2015, datë 17.12.2015 "Per Vetëqeverisjen Vendore", nenet 8/2, 9/1/1.1/b, 54, ligjit Nr.45/2019 "Për Mbrojtjen Civile" Neni 30 shkronja "gj", VKM Nr. 329, datë 16.05.2012 "Për kriteret dhe proçedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimet njerëzore", kërkojmë:

Miratimin e dëmit të shkaktuar në banesën e saj në ***Fshatin Golaj, Lagjia Brati, Njësia Administrative Golaj,*** **Bashkia Has**, ***nga Fondi i Kushtëzuar i Buxhetit të Shtetit për vitin 2026.***

Mbi dëmtimin e shkaktuar në banesën e tij sipas kerkesës së ardhur drejtuar Drejtorisë Mbrojtjes Civile, nga reshjet e dendura të shiut të datës 27.07.2026, komisioni konstatimit në bazë të urdhërit të ngritur nga Kryetari i Bashkise, verifikoi gjendjën në vend, dhe rezultoi se objekti nga hyrja e ujit në shtepi (bodrum) ku eshte duke jetuar per momentin, si pasoje e hyrjes së ujit nga reshjet e dendura te shiut, demtimet jane si me poshte:

- Paisje elektroshtepiake dhe orendi, si: bufe guzhine, dhome gjumi, divane 2 (dy), tavolin televizori 1 (nje), lavatriçe 1 (nje), frigorifer 1 (nje),
- Demtim i laminatit ne dy dhoma, demtim nga prezenca e ujit gjysem meter të lartesisë së murit nga prezenca e ujit në të gjithe hapësiren brenda kësaj banese (bodrum).
-Verifikimi u shoqërua me fotografi.

	Emri, Atësia, Mbiemri	Lloji i Fatkeqësisë	PREVENTIVI	Masa e Kompensimit
1	Shkelzen Halil Brati	Fatkeqësi Natyrore		
	PREVENTIV NDËRTIMI		102,545.5 Lekë	50% 51,272.75 Lekë

Adresa: Sheshi "Deshmoret e Hasit", Pallati i Kultures "Pjeter Bogdani", Qyteti Krumë, Rrethi Has,
Tel/Fax.: +355 214 22080, E-mail: info@bashkiahas.gov.al

	PREVENTIV ORENDISH		209.000 Lekë	100%	209.000 Lekë
	TOTALI				**260,272.75 Lekë**

Në mbështetje të VKM Nr.329, datë 16.05.2012 "Për kriteret dhe proçedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimet njerëzore".

Vlera totale e preventivit të banesës për të cilën ka për të marrë qytetari z. Shkelzen Halil Brati është **260,272.75 Lekë**.

Përgjegjësi i Emergjencave Civile

Fatos Ahmati

Sektori Juridik

Aida Bera

Drejtoresha e Mbrojtjes Civile

Arbërie Rada

KRYETARI

Miftar DAUTI

Adresa: Sheshi "Deshmoret e Hasit", Pallati i Kultures "Pjeter Bogdani", Qyteti Krumë, Rrethi Has,
Tel/Fax.: +355 214 22080, E-mail: info@bashkiahas.gov.al